

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej anëtarëve të Gjykatës së Lartë :

**Ardian DVORANI** - Kryesues

**Arjana FULLANI** - Anëtar

**Andi ÇELIKU** - Anëtar

Në datën **01.03.2017** mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen Administrative me **Nr. 31003-04683-2014 akti** që ju përket palëve :

**PADITËS:** **Pranvera Aliaj**

**E PADITUR:** **Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës**

**OBJEKTI:** Shpërblimin në masën pagës së një viti për shkak të zgjidhjes së menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës në bazë të nenit 155 të K.Punës, shpërblimin në masën e dy pagave mujore për mosrespektim të afatit të njoftimit të parashikuar nga neni 143/1 të K.Punës, shpërblimin në masën e dy pagave mujore për mosrespektim të procedurës së parashikuar nga neni 144 në bazë të pikës pesë të K.Punës dhe shpërblimin për vjetërsi në punë në masën e 2 pagave mujore sipas nenit 145 të K.Punës.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 143, 144, 145, 155 të K.Punës.

**Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë**, me vendimin Nr.357, datë 03.02.2014 ka vendosur: Pranimin e padisë.

Detyrimin e të paditur të paguajë paditëses 2 muajve pagë për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Detyrimin e të paditur të paguajë paditëses 1 vit pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pajustificuar.

Detyrimin e të paditur të paguajë paditëses një javë paga si shpërblim për vjetërsi.

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë**, me vendimin Nr.2343, datë 10.06.2014 ka vendosur:

Ndryshimin e Vendimit Nr.357, datë 03.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në këtë mënyrë:

Pranimin e pjesëm të padisë.

Detyrimin e palës së paditur që ta dëmshpërblej paditësen me 2 paga mujore për shkak të mosrespektimit të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës.

Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë si të pabazuara në prova dhe në ligj.

\*\*\*

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë:

**V E N D O S I**

Prishjen e vendimit Nr.2343, datë 10.06.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe lënien në fuqi të vendimit Nr.357, datë 03.02.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**Tiranë, më datë 01.03.2017**

**Nr. 31003-04683-00-2014 i Regj. Themeltar**

**Nr. 00-2017-187 i Vendimit (89)**